



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 42

Datë: 21. 10. 2020. Ora: 15:30.

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtişi.

SKQZ: Burmi Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:
 - **Këshilli për Personel:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i angazhimi i stafit jo permanent në zgjedhjet e Mitrovicës së Veriut.
 - Zgjatja e orarit të punës për stafin e Sekretariatit të KQZ-së.
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore**
 - Shqyrtimi i draft vendimit për caktimin e afateve të aktivisteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, që do të mbahen më 29 nëntor 2020.
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut dhe Podujevës,
 - **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**
 - Plani i buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, dhe buxheti shtesë për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës,

- Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut dhe Podujevës,

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: E hapi mbledhjen e 42-të të KQZ. Është rendi i ditës...! Kisha propozuar, fillimisht që këshilli për buxhet të filloj i pari, sepse e kemi pak më urgjent...!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Buxhet dhe Financa:

Plani i buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, dhe buxheti shtesë për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës

Sami Hamiti: Në këshill, kemi shqyrtuar planin e buxhetit për kryetar Komune në Mitrovicën e veriut, dhe buxhetin shtesë për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunën e Podujevës. Shtesën, e kemi vu mbasi që i kemi analizuar mirë çështjes, dhe shtesa interferon te pjesa e UV llampave të cilave, ju ka skaduar afati. Këtu nuk mundemi të kalkulojmë, sepse nuk mund të lejojmë probleme eventuale.

Është edhe çështja e informimit publik, pjesa e transportit të materialit sensitiv, dhe të listës votuese. Këto, nuk janë shpenzim kushedi çfarë...

Shpenzimet në Mitrovicën e veriut, del që janë më të vogla në krahasim me zgjedhjet e jashtëzakonshme për një komunë, sepse kemi paralelisht dy komuna, dhe stafi angazhohet paralelisht për të dy komuna...

Pjesa tjetër që lidhet me kovidin, mendoj që duhet të veprohet nga Sekretariati që për stafin të ketë maska dhe preparate tjera të nevojshme në vendvotime...

Valdete Daka: Pra, kush është që ky plan të votohet ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë plan

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut dhe Podujevës

Sami Hamiti: Duhet një miratim formal, mjetet janë por sipas ligjit duhet të miratohet dhe ka të bëjë me një shtesë prej 40 orëve...! Kjo është me ligj. Janë përfillë vërejtjet, dhe kjo është votuar unanimisht në këshill...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë plan.

3.Këshilli për Personel

Shqyrtimi dhe miratimi i angazhimi i stafit jo permanent në zgjedhjet e Mitrovicës së Veriut:

Ibrahim Selmanaj: Në mungesë të kryesuesit, do ju informoj unë rreth takimit të këshillit. Kemi diskutuar për zhvillimet që janë në këto dy komuna. Pra, duke e pasur parasysh se kemi pasur të angazhuar, padyshim në bazë të kontratës, besoj do të vazhdojmë me këtë staf të rekrutuar dhe, do ta rekrutojmë stafin për komunën e Mitrovicës së veriut... Gjithashtu, anëtarët e KKZ-ve në Podujevë që janë të emëruar të fillojnë punën menjëherë, dhe stafit që u janë pezulluar kontratat të ju vazhdohen kontratat...

Në përgjithësi, për stafin që ka qenë i angazhuar nuk kemi nevojë për buxhet shtesë, me përjashtim të katër pozitave që janë të nevojshme – për trajner në Podujevë, dhe në Mitrovicën e veriut...

Kush është për...?

Anëtarët e KQZ, miratuan këtë raport të këshillit për personel

Zgjatja e orarit të punës për stafin e Sekretariatit të KQZ-së:

Ibrahim Selmanaj: E kemi diskutuar edhe këtë pikë. Është propozimi, vendimi është dhe, ne rekomandojmë për votim...

Valdete Daka: Stafi që nuk ka nevojë të qëndroj mbas orarit, ata mund të qëndrojnë por, të tjerët nuk janë të detyruar të jenë nëpër zyra... Madje, edhe të shtunën dhe të dilet të mos jenë të detyrueshme...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Alim Rama, i cili tha se, të evidentohen orët shtesë, dhe të jenë të arsyeshme... Arianit Elshani, tha se po, qëndrimi ynë është që të mos obligohen të gjithë zyrtarët të jenë në zyre, por puna që bëhet jashtë orarit, të jetë e arsyeshme...dhe, madje të jemi sa më racional në shpenzime...

Gjithashtu, Sami Hamiti sugjeroi që, t'i përmbushin kërkesat e auditorit të brendshëm dhe të jashtëm...

Valdete Daka: Pra, kush është për zgjatjen e orarit të punës, me vërejtjet që u thanë...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.

4. Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi i draft vendimit për caktimin e afateve të aktivisteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, që do të mbahen më 29 nëntor 2020:

Alim Rama: Në këshill, kemi trajtuar të dy pikat që janë të ndërlidhura: planin operacional, dhe vendimin për shkurtimin e afateve. Pra, disa afate, gjithsesi duhet të shkurtohen. Në parim, jemi pajtuar që të gjitha shumica e aktiviteteteve në Podujevë, duhet të ri përsëriten...madje, edhe fushata në Podujevë...mendoj që duhet të përsëritet... Kjo nuk është në draft...por kisha rekomanduar....Kurse, në Mitrovicën e veriut fushata prej 12 – 27 nëntor, pra është 15 ditë...

Në këtë pikë, diskutuan: **Sami Hamiti**, që tha se në Podujevë procedurat janë krye, kurse tjetër është për Mitrovicën e veriut, ndonëse nëse i referohemi ISHKP-së, kovidi është dhe mendoj se nuk do të ketë fushatë... Ndërsa, **Arianit Elshani** tha në parim se, aftët për Mitrovicën e veriut të miratohen, kurse për Podujevën duhet edhe një takim që, të përcaktohen qartë specifikat që duhet realizuar, afatet, sepse mendoj që janë dy çështje të ndara...

Valdete Daka, tha se ne t'i votojmë njëherë afatet për Mitrovicën e veriut, e për Podujevë të diskutohet edhe njëherë në këshill, ose të diskutojmë të gjithë së bashku, dhe pastaj, në mbledhjen e ardhshme shohim...Madje, të takohet edhe këshilli ligjor dhe këshilli operacional, dhe t'i diskutoj disa çështje, t'i shoh të gjitha specifikat...sepse, ka aktivitete që s'di nëse mund të përsëriten edhe njëherë...t'i shikojmë çështjet më hollësisht...

Kush është për....?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan caktimin e afateve të aktivisteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut dhe Podujevës:

Alim Rama: Këshilli, ka shqyrtuar edhe këtë pikë dhe, ne rekomandojmë për miratim këtë plan operacional...

Valdete Daka: Sipas këtij plani, unë nuk e di nëse të dy komunat, mund të jenë në të njëjtin plan, sepse në momentin që ne marrim vendim I bie që ne t'i realizojmë të gjitha këto specifika...Mirëpo, unë thash që të shikohen edhe njëherë, sepse ka aktivitete që vështirë mund të realizohen dhe pastaj, mund të ketë ankesa...Ndoshta, është mirë që edhe njëherë ta shikojmë këtë, dhe nëse pajtoheni, unë them ta votojmë vetëm planin operacional për Mitrovicën e veriut...

Arianit Elshani: Jam dakord me ju, pra të votojmë vetëm planin operacional për Mitrovicën e veriut, ndërsa për Podujevën, ta trajtojmë edhe njëherë planin...

Alim Rama: KOZ, nuk ka fuqi vendimmarrëse, kështu që mendoj që KOZ duhet ta diskutoj këtë...

Valdete Daka: Unë, kam një kërkesë për Sekretariatën si bartësi kryesorë I organizimit të zgjedhjeve, sidomos në komunën e Mitrovicës së veriut...! Ne, kemi pasur përkrahje nga OSEB, por nëse Sekretariati na garanton organizimin, atëherë vazhdojmë...

Burim Ahmetaj: Sa i përket kësaj kërkesë, ne do ta shqyrtojmë kërkesën, do ta analizojmë dhe besoj, nesër edhe do ta japim përgjigjen, ndërsa sa i përket planit operacional, në fakt gjithçka që ndërlidhet me komunën e Podujevës, ndoshta do të na duhet me e përgatitur një plan të ri... Sepse, sigurisht që ka ndryshime...Mirëpo, ka aktivitete që na duhet t'i bëjmë ndryshimet, varësisht prej situatës...

Valdete Daka: Faleminderit Burim! Pra, kush është për miratimin e draft-planit operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut ?

Anëtarët e KOZ-së, miratuan këtë plan.

4. Të ndryshme !